

VENDIM
Nr.6, datë 2.2.2015

MBIKËRKESËN E OST SHAPËR RISHIKIMIN DHE PEZULLIMIN E VENDIMIT
NR. 141,DATË 26.12.2014 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s“PËR
PËRCAKTIMINETARIFËS SË SHËRBIMEVE NDIHMËSE PËR VITIN 2015”

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16, pika 3, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbikërkesën e OST sh.a.për rishikimin dhe pezullimin e vendimit nr. 141 datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për përcaktiminetarifës së shërbimeve ndihmëse për vitin 2015”,

konstatoi se:

- Mënyra e shpërndarjes së kostove në sistemin elektroenergjetik është diskrecion i ERE-s e cila është e detyruar me ligj të mbulojë të gjitha kostot e nevojshme për segmentet e tregut të rregulluar, për mirëfunksionimin e tij.

- Tarifa e shërbimeve ndihmëse aplikohet për herë të parë dhe konsiderohet në fazë eksperimentale.

- Është lënë detyra që, brenda tremujorit të parë të vitit 2015 të rishikohet midis palëve saktësia e llogaritjes dhe testimi i aplikimit të kësaj tarife.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së OST sh.a.për rishikimin dhe pezullimin e vendimit nr.141, datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për përcaktiminetarifës së shërbimeve ndihmëse për vitin 2015” si të pabazuar në prova të reja që mund të çojnë Bordin e Komisionerëve të ERE-s në një vendim të ndryshëm nga ai i marrë në vendimin nr.141, datë 26.12.2014.

2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 141 datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për përcaktiminetarifës sëshërbimeve ndihmëse për vitin 2015”.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti